



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr. 588/2025

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Balli Kombëtar (PBKDSH) me seli në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.02.2025, merr këtë:

## V E N D I M

**HEDHET** e palejuar ankesa A.nr.588/2025, e datës 15.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Partia Balli Kombëtar (PBKDSH) me seli në Gjakovë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 09 Shkurt 2025.

## A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.588/2025, të datës 15.02.2025 nga subjekti politik Partia Balli Kombëtar (PBKDSH) me seli në Gjakovë, në të cilën pretendon se sipas informatave të marra nga shtypi ditor dhe reagimet e partive politike si dhe nga informatat e marra nga vëzhguesit e këtij subjekti, kemi konstatuar dhe kemi dyshim të bazuar se me rastin e numërimit të votave, qëllimisht nga subjektet e tjera e komisioneret e vendvotimeve në procedurën e numërimit ka ardhur deri tek shkelja e dispozitave ligjore, me të cilin rast votat e orientuara në subjektin tonë janë keqpërdoruar nga komisioneret me rastin e votimeve dhe u janë bartur subjekteve tjera apo partive të cilat kanë konkuruar në këto vendvotime dhe atë në këto vend. Në bazë të parregullsive të identifikuar kërkohmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) që të ndërmarrë veprime të më poshtme: Verifikimi i pretendimeve përmes hetimit të drejtuar nga autoritetet përkatëse, Rinumërimi i votave në qendrat e votimit; Shpallja e pavlefshme e

votimit në rast se parregullsitë kanë ndikuar në rezultatin zgjedhor; Ndëshkimin e personave përgjegjës nëse provohet se ka pas shkelje të qëllimshme; Masa të tjera që PZAP i konsideron të domosdoshme për të garantuar drejtësinë zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si prove deklaratën e Kryetarit Nikoll Perhaj, në të cilën po ashtu theksohet se: në baze të fakteve dhe deklarimeve që kemi po ju drejtohem Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), Zgjedhjet Parlamentare në Kosove me 09.02.2025 të cilat u mbajtën të dielën subjektin tone e kanë dëmtuar shumë në baze të dhënave të anëtarëve tanë dhe familjareve të ngushte të kandidatëve që janë pjesë e listës zgjedhore, si 1: Numri i votës se lire të deklaruar nga familjarët e kandidatëve tanë është shumë me i larte se numri i votave të postuara në faqen e KQZ në gjitha Komunitatet e Kosovës . 2: Subjekti Politik LVV mbas daljes se rezultateve nëpër disa Komuna të cilat janë të dokumentuara me materialin e kësaj deklaratë na i ka marruar 716 vota të Ballit Kombëtar 0104/01 SHFMU Drita Gramoqel Deçan :64 vota, 0402/11 SHFMU Thimi Mitko Gjilan :288 vota, 0617/02 SHFMU Ismail Qemali Saradran Istog :150 vota, 1917/02 SHML Ahmet Gashi Prishtine :220 vota, 2010/01 SHFMU Mati Logoreci Prizren : 200 vota, 2805/01 SHFMU Petar Kociç bube Zubin Potok :121 vota. Në këto vendvotime, Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar ka 58/243/135/159/121/. Te dhënat e me sipërme dhe veprimet e subjekteve tjera në dëme të subjektit tone, janë dëshmi të mjaftueshme se në rastin konkret votat e subjektit tone janë shpërdoruar edhe me shume se sa ne kemi paraqitur prova, prandaj mbetet në organin kompetent që të vërtetoji dhe konstatoji gjendjen faktike dhe të ndërmarr masa të parapara ligjore

Në përgjigjen në ankesë nga KQZ, theksohet se bazuar në nenin 3 paragrafi 1.38 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) - do të thotë lokacioni në secilën komunë ku numërohen fletëvotimet dhe votat e kandidatëve të subjekteve politike, në mënyrë transparente në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar, si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit, ndër Funkcionet e QKN është edhe numërimi i fletëvotimet dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike.

Pretendimet janë të pa bazuara, sepse ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave dhe nuk ka mundur të konstatoj se ka pasur manipulim të votave, për faktin se thëniet e ankuesit nuk mbështetën në ndonjë provë konkrete, si Formularët e Rezultateve të Subjekteve Politike, libri i votimit, deklaratat e KVV si dhe numërimin e votave në QKN.

Provat e paraqitura në ankesë nuk janë prova nga Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në komunat e specifikuar në ankesë, por janë Rezultatet preliminare nga vendvotimet të cilat kanë mundur të ndryshohen, korrektohen dhe plotësohen, nga Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), e cila mundëson verifikimin dhe evitimin e çdo gabimi teknik që kanë mundur të ndodhin në vendvotimet të specifikuar nga ankuesi nëse konstatohet gjatë procedimit në QKN se ka pasur parregullsi.

Gjithashtu, Informatat e marra nga shtypi ditor dhe reagimet e partive politike nuk janë fakte që dëshmojnë se ka pasur parregullsi dhe keqpërdorime të votave janë supozime, se qëllimisht komisionarët e subjekteve politike votave e subjektit politik PBKDSH-të, i janë bartur subjekteve.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duk përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunave përkatëse, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohen parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 106.3 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, parashihet se “personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë; cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij.....”. ndërsa në paragrafin 4 të këtijneni parashihet se “*Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja.....*”, andaj Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga subjekti në fjalë është e palejuar, pasi që ka të bëjë me mospërputhje të rezultateve të publikuar nga KQZ-ja, në krahasim me pretendimin e subjektit ankues, që do të thotë pretendim ankimor lidhur me rezultatin e zgjedhjeve (*edhe pse nuk ka pasur publikim të rezultateve përfundimtare*).


Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LQP-së i cili parasheh se “*PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht*” dhe Nenit 13.3 të Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “*PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LQP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim*”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar, e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore pala mund ta atakoj rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**A nr. 588/2025 më datën 18.02.2025**

**Kryesues i Panelit**  
**Arsim Hamzaj**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.